



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Data: 16.07.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për Ri-Shqyrtim të datës; 14.07.2025, të parashtruar nga "Rahovica Commerce SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e infrastrukturës në qytet dhe fshatra" me nr. të Prokurimit 613-25-1158-2-1-1 Autoriteti kontraktues nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim, kërkesë e paraqitur më dt; 14.07.2025, nga "Rahovica Commerce SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:

"Mirëmbajtja e infrastrukturës në qytet dhe fshatra" me nr. të Prokurimit 613-25-1158-2-1-1.

Vërtetohet, Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i publikuar në platformen e prokurimit të datës: 09.07.2025.

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti kontraktues Komuna e Lipjanit ka pranuar kërkesë për Rishqyrtim më dt: 14.07.2025, për aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja e infrastrukturës në qytet dhe fshatra" me nr. të Prokurimit 613-25-1158-2-1-1, përmes sistemit elektronik në E-prokurim.

Pergjigjeja në pretendimin e parë :

Gjatë vlerësimit të ofertave, është konstatuar se operatori ekonomik ka paraqitur çmime të jashtëzakonshme për disa pozicione specifike, të cilat janë dukshëm më të larta sesa çmimet mesatare të tregut dhe çmimet e ofertave të tjera konkurruese në procedurë, pozicione të cilat i kemi elaboruar me poshte.

Pretendimi juaj eshte se çmimet janë justifikuar për shkak të sasive të vogla dhe mobilizimit të makinerive, mirëpo këto nuk përbëjnë bazë për të tejkaluar çmimet e tregut në nivel të konsiderueshëm, veçanërisht kur konkurrenca ka ofruar çmime dukshëm më të ulëta për të njëjtat njësi.

Ne baze te rregullores se prokurimit publik, RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

4.1 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim:

citoj rregulloren e lartecekur neni 4 pika “c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut”

Duke u bazuar ne çmimet tuaja ne këtë oferte ne kemi ardh ne perfundim qe per m² çmimi juaj arrin vleren prej 195 euro qe eshte mbi qdo çmim te tregut duke u bazuar edhe ne ofertat tjera pjesmarrese per kete AP,

Elaborim: pozicioni 1.2 Prerja profesionale sipas standardeve ne vendet e demtuara të rrugeve të asfaltuara, prerja me makine profesionale për prerje, rruget e asfaltuara me trashesi sipas gjendjes ekzistuese në teren , trashesia T1=7cm dhe T2=5cm, paguhet me m' = 20 € per m' nese behet prerja per 1 m² dmth meter gjatesi jane 4 m' qe nje prerje prej 1 m² ne total eshte = 80 €,

Elaborim: pozicioni 1.3 Demolimi i asfaltit ekzistues në vendet e demtura, thyerja pas prerjes, te realizohet me kompresor ose çekiq hidraulik, paguhet me m² në çmim të llogaritet edhe ngarkimi dhe transporti deri në deponi ky pozicion eshte vlersuar 30 € per m²

Elaborim: pozicioni 1.4 Grryerja e asfaltit në rrugët e demtuara me makin adekuate per grryerje Frezë, frezimin e shtreses së asfaltit të plasaritur Tipi -1 i rrugës pregaditjen e bazez për asfaltim , Furnizimi me material dhe lyerja me emulzion e sipërfaqes së rruges ku kryhet intervenimi para shtruarjes së asfaltit, paguhet me m². ky pozicion eshte vlersuar 15 € per m²

Elaborim: pozicioni 1.5 Furnizimi dhe punimi i shtresës së Asfaltbetoni 011-016 mm me trashësi t=7 cm, dhe ngjeshja sipas standardeve per ket lloj pozicion..Si dhe lyerja me emulzion e sipërfaqes së rruges ku kryhet intervenimi para shtruarjes së asfaltit, Ne çmim te kalkulohen edhe testet marshall sipas standardeve per ket pozicion. ky pozicion eshte vlersuar 70 € per m²

Sqarim: per 1 m² prerje, demolim, gerryerje, asfalt m² arrin vleren 195 €


Ky çmim eshte vlersuar si çmim abnormalisht i larte duke krahasuar edhe ofertat tjera pjesmarrese ne kete AP. poashtu edhe ne çmimet e tregut qe jane ne vendin tone.

Pretendimi juaj është i pa bazuar.

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lartë, më dt; 16.07.2025, ka vendosur si ne dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Bekim Shabani

Drejtör i Prokurimit